

Njoftim

Sot, më datë **05.04.2023**, ora **14:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Manjola Xhaxho (Relatore);**
- 2. Edlira Petri (Anëtare);**
- 3. Marsela Dervishi (Anëtare);**
- 4. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Tiranë, salla nr. 2, pasi shqyrtoi çështjen Nr.6 Regj.Themeltar, Datë 27.03.2023 Regjistrimi, me:

PADITËS: Lodovik HASANI, përfaqësuar nga Avokati Tonin Prendi.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

OBJEKTI: Shfuqizimin e pikës 3 të Vendimit nr.7, datë 25.01.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve "*Vendim për shqyrtimin e kërkesës nr.04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*", për atë që ka të bëjë me vendosjen e sanksionit administrativ, kundër Z. Lodovik Hasani, në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

BAZA LIGJORE: Kodi i Procedurës Administrative, neni 132/1 të tij si dhe Kreu 1, Rregullat e Përgjithshme të Njoftimit, Nenet 147 e vijues të tij. Ligji nr.10019 datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, neni 145, 152, 153, 158/b të tij.

me Vendimin Nr. 7 datë 05.04.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e padisë.
2. Shfuqizimin e pikës 3 të Vendimit nr. 7, datë 25.01.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në lidhje me gjobën vendosur ndaj z. Lodovik Hasani.
3. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
5. U shpall në Tiranë më datë 05.04.2023.

Tiranë, më 05.04.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë